



Komisioni Qendror i Zgjedhjeve • Centralna Izborna Komisija • Central Election Commission
Republika e Kosovës • Republika Kosova • Republic of Kosova

PROCESVERBAL NGA MBLEDHJA E KOMISIONIT QENDROR TË ZGJEDHJEVE

Mbledhja nr. **09/2025**

Data: **30 janar, 2025. Ora: 13:30**

Vendi: **Votim në procedurë qarkulluese (online)**

Kryesues i KQZ-së: Kreshnik Radoniqi.

Anëtarët e KQZ-së: Sami Kurteshi, Arianit Elshani, Ilir Gashi, Sami Hamiti,
Alban Krasniqi, Ibrahim Selmanaj, Fazli Stollaj, Gordana Llaban, Qemailj

Në takim ishin të Kurtis, Mufera Shinik

pranishëm:

U.D. Drejtori i SKQZ dhe Drejtor i ZRCKFSP: Besnik Buzhala

Përkthyes: Jehona Cami

Procesmbajtës: Fehmi Ajvazi

RENDI I DITËS

1. Hyrje: z. Kreshnik Radoniqi, Kryesues i mbledhjes së KQZ-së

2. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit të mbledhjes Nr. 08/2025

3. Këshillat e KQZ

3.1. Këshilli për Operacione Zgjedhore

- 3.1.1. Shqyrtimi dhe miratimi i rekomandimit për ndryshimin e lokacionit të Qendrave të Votimit 1211, 1207 dhe 1210, në komunën Leposaviq
- 3.1.2. Shqyrtimi dhe miratimi i Këshillave të Vendvotimeve për vendvotimet e rregullta, me kusht dhe ekipet e numërimit në QKN
- 3.1.3. Shqyrtimi dhe miratimi i Këshillave të Vendvotimeve në Përfaqësi Diplomatike

3.2. Këshilli për Buxhet dhe Financa

- 3.2.1. Shqyrtimi dhe miratimi i Raportit Vjetorë Financiar i KQZ-së për vitin 2024,
- 3.2.2. Shqyrtimi dhe miratimi i Raportit Vjetorë të Derivateve për vitin 2024,

3.3. Këshilli për Marrëdhënie me Jashtë

5. Të ndryshme !

1.Hyrje: z. Kreshnik Radoniqi, Kryesues i mbledhjes së KQZ-së:

Kreshnik Radoniqi: Kryetari Radoniqi, si zakonisht paraqiti pikat e rendit të ditës dhe i pyeti anëtarët nëse, kanë diçka për të shtuar, ndonjë vërejtje...? Gordana Llaban, kërkoi që anëtarët të kenë materialet e pikave të rendit. Ndërsa, z. Arianit Elshani, propozoi dy pika: Plotësim – ndryshimi i projektit për transparencë të qendrës komunale të numërimit, dhe pritja e vëzhguesve ndërkombëtarë. Ibrahim Selmanaj, tha se me datën 3 shkurt tërhiqen fletëvotimet në Shtutgard dhe Cyrih ishte dashur të ishte dikush nga KQZ. Kjo, do e rriste transparencën.

Me 11 vota për, miratohet rendi i ditës.

Në vazhdim, anëtarët e KQZ-së miratuan procesverbalin e mbledhjes nr. 08/2025 të KQZ-së: 10 vota për, dhe 1 abstenim. Abstenoi z. Sami Kurteshi, i cili e përkufizoi përmbajtjen jo të plotë.

2. Këshillat e KQZ

Këshilli për Operacione Zgjedhore

1.Shqyrtimi dhe miratimi i rekomandimit për ndryshimin e lokacionit të Qendrave të Votimit 1211, 1207 dhe 1210, në komunën Leposaviq:

Arianit Elshani, e informoi KQZ-në për ndryshimin e lokacionit të Qendrave të Votimit 1211, 1207 dhe 1210, në komunën Leposaviqit. Janë 3 kërkesa. Bëhet fjalë për fshatin Borqan që nuk i plotëson kushtet, dhe është rekomanduar që kjo CV të bartet në fshatin Soqanicë e Epërme. Qendra e Votimit në Kushtovë, rekomandohet të bartet në objekt privat brenda fshatit. Rekomandimi tjetër është që QV e vendosur në objektin shtëpia e gjuetisë “Bistrica”, të zhvendoset në Jarinje të poshtme.

Me 9 vota për dhe 2 abstenime (Gordana Llaban dhe Mufera Shinik), miratohet ky rekomandim.

2.Shqyrtimi dhe miratimi i Këshillave të Vendvotimeve për vendvotimet e rregullta, me kusht dhe ekipet e numërimit në QKN:

Arianit Elshani: Ne, kemi shqyrtuar edhe KV-të për vendvotimet e rregullta, me kusht dhe ekipet e numërimit në QKN. Gjithsej, janë 14, 991 anëtarë të këshillave të nominuar nga subjektet politikes sipas formulës së KQZ-së. Rekomandojmë, miratimin e tyre. Që nga nesër, të fillojnë trajnimet. Një gjë: kërkojmë edhe njëherë që të gjithë ata që janë komisioner në KVV, të kenë parasysh se në çdo vendvotim do ketë kamera dhe, kushdo që cenon procesin mund të ndiqet penalisht...

Alban Krasniqi, tha se dje kemi dhënë njoftimin për ti konfirmuar disa parregullsi në disa komuna. Fjala është për fenomenin e vendosjes së personave të komunitetit të caktuar, në emër të po komunitetit të caktuar. Shembull i këtij fenomeni, është komuna e Dragashit. Në bazë të një analize të lehtë, shihen qartë emra shqiptarësh të vendosur në emër të partive boshnjake apo edhe turke, dhe e kundërta. Këtu, shkelet parimi jo më shumë se një anëtar i subjektit politik në një vendvotim. Ka dëshmi të caktuara, dhe unë i bëj thirrje prokurores Laura që komunën e Dragashit ta shikoj në detaje...!

Shqetësimi im, tha z. Krasniqi, mendoj se vet zyrtari ynë i KKZ-së është i involvuar në këtë proces dhe kërkoj që të ndërmerren masa. Këtë fenomen, nuk mund ta tolerojmë! Ne, kemi pasur presion prej komuniteteve pakicë me rritë numrin dhe tash ky numër, në disa vende ka reflektue me rritjen e numrit të vëzhgues të komunitetit shqiptarë që vijnë nga partitë shqiptare sepse, janë ba marrëveshje. Dy veprime duhet ndërmarrë. Një veprim yni i brendshëm që e kemi bërë njoftim sapo i kemi pa këto veprime për KKZ-të me fakte dhe nuk është ndërmarrë asnjë veprim, dhe dy, pazare nuk mund të bëj me

komisioner askush dhe, ne duhet tu japim mesazh subjekteve politike. Le të ndërmerren masat, tha ndër të tjera z. Krasniqi.

Qemailj Kurtis, tha se ka pasur ndryshime por, mendoj që kjo nuk është bash kështu...! Ka mbiemra të ndryshëm që, duken të njëjtë. Por, ka edhe bashkëshortësi të përziera: nëna boshnjake, babai shqiptar dhe e kundërta ! Në Dragash, ne kemi tanët, po flas për koalicionin Vakant dhe nuk ka kësi rastesh... Ne, kemi qenë të kujdesshëm. Së paku koalicioni Vakant nuk ka asnjë lloj marrëveshje me asnjë subjekt, as nuk kemi pasur bisedime, as... Mendoj se, është gjithçka në rregull. Në fund të fundit, jemi këtu për interesat e bashkësive që përfaqësojmë dhe, nuk jemi këtu për t'i komprometuar ! Koalicioni Vakant i ka bërë listat e veta, dhe është përgjegjës...

Fazli Stollaj: Kam vërejtje për komunën e Deçanit: të nominuarit e IRDK-së janë në mënyrë të pa autorizuar ! Është bërë me dije. Dhe unë propozoj të largohen. Ne, nuk kemi pasur propozime për komunën e Deçanit...

Në këtë pikë, diskutuan gjerësisht më tej: Alban Krasniqi, Arianit Elshani, Ilir Gashi, Kreshnik Radoniqi, Sami Kurteshi, Ibrahim Selmanaj, dhe Sami Hamiti.

Në fund, anëtarët e KQZ-së në parim, me 10 vota për dhe 1 abstenim u miratuan Këshillat e Vendvotimeve për vendvotimet e rregullta, me kusht dhe ekipet e numërimit në QKN-së.

3. Shqyrtimi dhe miratimi i Këshillave të Vendvotimeve në Përfaqësi Diplomatike:

Arianit Elshani: KOZ-i ka shqyrtuar edhe listën e nominimeve të partive politike për komisionarët në përfaqësitë diplomatike. Numri i tyre, arrin në 154 komisionarë. Me vetëm 1 nominim dhe ku duhet të shtohet edhe një nga administrata e përfaqësive diplomatike është Stambolli, Shkupi, Otava, Budapesti dhe Praga. Kur shtohet edhe një nga ambasadat, numri i tyre shkon në dy. Ne, do të kërkojmë nga përfaqësitë diplomatike që të plotësohet numri në dy i komisionarëve. Pra, do të funksionalizohen këshillat në këto shtete.

Alban Krasniqi, tha se aty ku janë mbi 400 votues të regjistruar, të sigurohemi që të ketë komisionerë. Kjo mund të bëhet, plotësimet mund të bëhen duke llogaritur numrin e votuesve të regjistruar, me numrin e komisionarëve në vendvotimet e tjera.

Me 9 vota për, 2 abstenime miratohen këshillat e vendvotimeve për përfaqësitë diplomatike.

4. Shqyrtimi dhe miratimi i plotësim – ndryshimit të projektit për transparencë

Arianit Elshani, tha se kemi shqyrtuar këtë projekt. Si KQZ ne kemi sigurua laptopët për QKN. E falënderoj që këtu Entin e Statistikave që na i ka huazue laptopët për numërimin e votave të kandidatëve për futjen e të dhënave në platformën e KQZ.

Kemi për ti tenderuar televizorët, mbajtësit e tyre, dhe kabllot lidhëse e ndërlidhëse. Këto janë 3 kontrata që të funksionalizohen QKN-të.

Me 10 vota për, miratohet ky rekomandim.

Këshilli për Buxhet dhe Financa

Shqyrtimi dhe miratimi i buxhetit të shpenzimeve për pritjen e vëzhguesve ndërkombëtarë të zgjedhjeve për Kuvendin e Kosovës që mbahen më 9 shkurt, 2025:

Arianit Elshani: Ne, kemi miratua një buxhet për vëzhguesit ndërkombëtar të zgjedhjeve. Tri ditë, do kemi vëzhgues. Vëzhgues nga Aweb dhe Armenia do qëndrojnë një ditë më shumë për shkak të udhëtimeve të tyre. Ne, kemi konsideruar që nuk ka nevojë si KQZ të marrim vendim. Ushtruesi i drejtorit të sekretariatit, ne parim ta autorizojmë të procedojë më tutje. Buxheti është...

Kreshnik Radoniqi: Një pikë e pati Ibrahim. Ai, propozoi që të jetë prezentë dikush nga KQZ për vëzhgim të procesit në Cyrih në dhe Shtutgard...!

Arianit Elshani: Në parim, ne kemi ra dakord në KOZ. Por, kjo varet nga ne. Kushdo që ka kohë, mundësi në proces...

Alban Krasniqi, tha se nuk e sheh të arsyeshme por propozoi që dikush nga Sekretariati edhe mund të shkojë. Kreshnik Radoniqi, tha se ne mund ta udhëzojmë sekretariatit, Besnikun, drejtori nëse shkojnë...

Këshilli për Buxhet dhe Financa

Shqyrtimi dhe miratimi i Raportit Vjetorë Financiar i KQZ-së për vitin 2024:

Gordana Llaban: Jemi takuar në këshill, dhe e kemi shqyrtuar e analizuar raportin vjetorë financiar të KQZ-së për vitin 2024. KQZ –së i është ndarë një buxhet prej: 9, 874, 494 euro. Në raportin e saj të buxhetit, kryesuesja znj. Gordana, e informoi KQZ-në në detaje mbi ndarjen e buxhetit, destinimet e këtyre mjeteve, shpenzimet etj.

Alban Krasniqi, tha se duket një planifikim jo fort i mirë i shpenzimit. Një pjesë e shpenzimeve të buxhetit, nuk është planifikuar si duhet. Buxheti i pashpenzuar, tregon performancë jo të mirë. Planifikimet kapitale, zero... Prandaj, së paku të rishikohen të gjitha obligimet dhe ato të kryhen, tha ndër të tjera z. Krasniqi.

Me 8 vota për, u miratua raporti financiar i KQZ-së për vitin 2024.

Shqyrtimi dhe miratimi i Raportit Vjetorë të Derivateve për vitin 2024:

Gordana Llaban: Në periudhën janar – dhjetor, KQZ ka shpenzuar 17, 081 litra derivate. Në raport, u dhanë shifrat e kilometrave të kaluar. Bëhet fjalë për 15 automjete të shfrytëzuara.

Me 9 vota për, miratohet ky rekomandim.

Këshilli për Marrëdhënie me Jashtë

Kreshnik Radoniqi: E kemi një ftesë për të marrë pjesë në një konferencë që mbahet në Lituani me temën “Stabiliteti i ligjit zgjedhor – çështjet praktike”. Mbahet më 15-16 prill, 2025. Kjo, është e dedikuar për drejtuesit e institucionit. Parimisht, në këshill u pajtuam të udhëtojmë unë dhe Besniku, sepse ftesa është e dedikuar. Por që, nëse ka interesim mund ta shtojmë numrin. U propozua që, të udhëtoj edhe Alban Krasniqi...

Të ndryshme !

Sami Kurteshi, tha se një ndryshim në KKZ ishe për këshillin ligjorë. Por që, këtë e kishte shqyrtuar KOZ-i. Me çështjet që kanë karakter ligjorë, duhet të merret ekskluzivisht këshilli ligjor...